



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(SHTOJCA 1)

BASHKIA.....

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

Nr. ____ prot. Datë __. __. 2024

Nr. ____ prot. Datë __. __. 2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI (TIP)

“Agjencia Shtetërore e Kadastrës” (ASHK), me seli në Tiranë, Rruga “Dora D’Istria”, person juridik publik, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Znj. Dallëndyshe Bici.

dhe

“Bashkia -----” , me seli në....., person juridik publik, përfaqësuar nga kryetari.....

Të dyja së bashku të referuara më poshtë si “Palët”

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e trajtimit me prioritet të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje në përputhje me legjislacionin në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë si dhe të rritjes së efikasitetit të këtyre procedurave administrative;

Të ndërgjegjshëm se përfshirja e bashkive në procese që lidhen me administrimin e territorit mundëson zbatimin më efikas të legjislacionit për planifikimin e territorit dhe është më pranë qytetarit;

Palët bien dakord për nënshkrimin e kësaj Marrëveshje sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje parashikon mënyrën e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit ndërmjet palëve në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në:

- Kushtetuta e Shqipërisë;

- Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 111/2018, “Për Kadastrën”;
- Ligji nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar
- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
- Ligjin nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Neni 3

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit midis ASHK-së dhe Bashkisë në kuadër të proceseve të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit të Bashkisë, në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Neni 4

Parimet e bashkëpunimit

Zbatimi i bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje realizohet në respektim të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe autonomisë vendore, të ligjshmërisë, transparencës, efikasitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 5

Mënyra e bashkëpunimit

Në kuadër dhe në zbatim të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, palët angazhohen të bashkëpunojnë, bashkëveprojnë dhe koordinohen në lidhje me sa vijon:

- Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion lidhur me ecurinë e procesit të legalizimit në funksion të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin e posaçëm për proceset tranzitore.
- Të komunikojnë, bashkërendojnë dhe koordinojnë veprimtarinë administrative ndërmjet tyre në funksion të realizimit të kësaj Marrëveshje;
- Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta, përcaktojnë planin e veprimit si dhe grafikun e prioritetëve në funksion të trajtimit me prioritet të procesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- Të caktojnë burime njerëzore e nevojshme për administrimin efikas të procesit administrativ. Për këtë qëllim, ASHK dhe Bashkia vlerësojnë nevojën dhe mundësitë reale për realizimin të këtij bashkëpunimi, duke përdorur të gjithë mekanizmat ligjor, financiarë dhe/ose në burime njerëzore në dispozicion për përmbylljen e procesi sipas afatit të përcaktuar në këtë Marrëveshje. Bashkia sipas rastit, mund të transferojë fond me terma dhe specifikime të veçanta, në favor të ASHK-së, për të mbuluar shpenzimet e pagave të stafit që do të angazhohet për zbatimin e këtij Vendimi. Në çdo rast, nëse palët vendosin transferimin e fondit nga Bashkia tek ASHK, fondi përdoret nga ASHK vetëm për qëllim të realizimit të këtij Vendimi dhe në përputhje me specifikimet

përkatëse. Bashkia, sipas rastit mund të vendosë në dispozicion të ASHK-së, nëpërmjet transferimit të punonjësve të Bashkisë pranë ASHK në funksion të realizimit të qëllimeve të kësaj Marrëveshje. Në këtë rast, për periudhën e kohëzgjatjes së Marrëveshjes, stafi i nënshtrohet procedurave ligjore të punësimit sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për kadastrën.

- Të informojnë Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor në mënyrë periodike në lidhje me ecurinë e zbatimit të Marrëveshjes dhe VKM-së për *“Rregullimin e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe vendore për përshejtimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje”*.
- Të bashkëpunojnë për realizimin sa më efikas, transparent dhe profesional të procesit administrativ në çdo formë tjetër që vlerësohet e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6 **Angazhimet e palëve**

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës në zbatim të kësaj Marrëveshje angazhohet të kryejë si vijon:

- a. Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për identifikimin dhe evidentimin e kërkesave të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në territorin e zonave me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale banimi.
- b. Të organizojë dhe caktojë stafin e drejtorisë vendore të ASHK-se në territorin e së cilës ndodhet nënzonat e propozuar nga Bashkia, në funksion të realizimit të këtij procesi me volumin e kërkesave.
- c. Të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shpenzimin e fondit të transferuar nga Bashkia sipas përcaktimeve të VKM-së dhe kësaj Marrëveshje. Të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe procedurat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me punësimin e stafit të Bashkisë për periudhën e kohëzgjatjes së Marrëveshjes.
- ç. Të bashkëpunoj me stafin e Bashkisë në kryerjen e procedurave të evidentimit në terren të objekteve në proces legalizimi në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale banimi.
- d. Të kryejë veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga Bashkia në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të Palëve. Përfaqësuesit e Palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm.
- e. Të trajtojë me prioritet në përputhje me legjislacionin në fuqi kërkesat e subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale banimi.
- f. Të informojë Bashkinë, pa vonesë, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti për problematikat e hasura gjatë procedurës administrative duke propozuar zgjidhje në funksion të ecurisë së procesit.

2. Bashkia në zbatim të kësaj Marrëveshje angazhohet të kryejë si vijon:

- a. Të identifikojë dhe hartojë një listë të subjekteve për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonave informale kryesisht me funksion banimi, të ndara sipas nënzona. Për këtë qëllim Bashkia, harton listën me nënzona brenda territorit dhe ia dërgon atë ASHK-së.

- b. Të përcjell tek ASHK, nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar si person kontakti, informacionin e grumbulluar dhe konsoliduar mbi evidentimin e subjekteve dhe ndërtimeve pa leje të zonës/bllokut përkatës, për procesim të mëtejshëm sipas legjislacionit në fuqi.
- c. Të vlerësojë krijimin e njësinë përgjegjëse dhe caktojë stafin që do të përfshihet në administrimin e procesit sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje.
- ç. Të identifikoj stafin e specializuar që do të vihet në dispozicion të ushtrisë detyrat pranë ASHK-së gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi, për propozimin dhe vënien në dispozicion për efekt të realizimit të parashikimeve të VKM-së. Të identifikojë fondin që mund t'i transferohet nga ASHK për qëllim të realizimit të këtij Vendimi dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për transferimin e fondit sipas parashikimeve të VKM-së dhe kësaj Marrëveshje.
- d. Të ofrojë ndihmë dhe informacion nëpërmjet stafit të Bashkisë për subjektet mbi statusin e aplikimit dhe fazën apo ecurinë e procesit, në bllokun gjeografik prioritar të identifikuar nga Bashkia;
- e. Të informojnë dhe sensibilizojnë subjektet në nënzona për procedurat e evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje që do të kryhet nga ASHK, si dhe të asistojë stafin e ASHK-së gjatë kryerjes së procedurave të evidentimit në terren të ndërtimeve pa leje;
- f. Të marrë pjesë në veprimet e evidentimit në terren për objektet pa leje në zonat/bllokun gjeografik prioritar të propozuar nga Bashkia në prezencë të përfaqësuesve të caktuar të Palëve. Përfaqësuesit e Palëve nënshkruajnë procesverbalin (formular informativ) të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së me urdhër të brendshëm.
- g. Të informojë ASHK në lidhje me projektet/ studimet e bashkisë të miratuara në zbatim të legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 7

Komunikimi midis Palëve

Rakordimi i veprimeve administrative dhe shkëmbimi i informacionit shkëmbimit të informacionit kryhet vetëm në formë shkresore dhe/ose elektronike.

Neni 8

Përdorimi i informacionit

Informacioni i mbledhur, përpiluar, procesuar dhe shkëmbyer midis Palëve sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, përdoret vetëm për realizimin e bashkëpunimit sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit në mënyrë periodike

1. Përfaqësuesit e Palëve mbajnë kontakt të vazhdueshëm në funksion të zbatimit efektiv të kësaj Marrëveshje. Përfaqësuesit zhvillojnë çdo muaj takime në lidhje me ecurinë e procesit administrativ.
2. Në fund të çdo muaji, çdo përfaqësues harton informacion të detajuar mbi ecurinë e procesit dhe ia dërgon përkatësisht Drejtorit të ASHK-së dhe Kryetarit të Bashkisë. Drejtori i ASHK-

së dhe Kryetari i Bashkisë i dërgojnë çdo muaj Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor informacionin e detajuar mbi ecurinë.

Neni 10
Afati i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe është e vlefshme 1 (një) vit nga momenti i nënshkrimit të saj.
2. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi bëhet në formë shkresore dhe me miratimin e të dy Palëve.
3. Secila Palë, nëse për arsye objektive është në pamundësi objektive për të përmbushur angazhimet sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, mund ta zgjidhë atë në mënyrë të njëanshme në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara.
4. Secila Palë, mund ta zgjidhë Marrëveshjen në çdo kohë, nëse Pala nuk respekton detyrimet e përcaktuara dhe nuk merr masa për rregullimin e pasojave brenda 10 ditëve nga njoftimi me shkrim i palës tjetër.

Kjo Marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale.

BASHKIA.....

KRYETAR

AGJENCIA SHETËRORE
E KADASTRËS

DREJTOR I PËRGJITHSHM